



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 07.11.2016

Ref.: 1248/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 88 (pika 2 a) i Ligjit mbi Procedurën Administrative (Ligji Nr.02/L-28, datë 22.07.2008), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 46-të, të mbajtur më 31 Tetor 2016, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji "Iliria" për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS; (250 studentë për vit akademik)
- Menaxhment dhe Informatikë, BA, 180 ECTS; (300 studentë për vit akademik)
- Menaxhmenti Shëndetësor, MA, 120 ECTS, (150 studentë për vit akademik)

II. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji "Iliria" për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2018:

- Banka, Financa dhe Kontabilitet, MA, 120 ECTS; (150 studentë për vit akademik)
- Menaxhment dhe Informatikë, MA, 120 ECTS; (150 studentë për vit akademik)

III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

IV. Obligohet BPrAL Kolegji "Iliria" që deri me datë 1 dhjetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Iliria" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Banka, Financa dhe Kontabilitet	BA	180	Mixhait Recic, Mirac Hani, Shpresa Reshidi
2	Menaxhment dhe Informatikë	BA	180	Nasir Selimi, Petrit Pollozhani, Merale Vehapi
3	Menaxhmenti Shëndetësor	MA	120	Bashkim Berberi, Admir Nake, Ismije Sahiti
4	Banka, Financa dhe Kontabilitet	MA	120	Shefket Jakupi, Arif Murrja, Adriatik Kotorri
5	Menaxhment dhe Informatikë	MA	120	Petrit Dollani, Halil Snopce, Azir Aliu

AKA ka organizuar vizitë në BPrAL Kolegji "Iliria" më 14.10.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Nevenka Cavklel, Prof. Dr. Volker Ghemlich.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 31 Tetor 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Iliria", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Iliria"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë